



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 981/1 Prot.

Tiranë më 11.05.2020

Lënda: Përgjigje kërkesës tuaj për mendim

DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka administruar kërkesën tuaj për mendim nr. 1893 Prot., datë 30.04.2020, në lidhje me heqjen nga lista e subjekteve vetdeklaruese të personave të cilët janë rehabilituar nga kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.

Referuar informacionit të paraqitur në kërkesën tuaj, në mbështetje të ligjit nr.138/2015 dhe të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, Departamenti i Administratës Publike, është institucioni i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me detyra administrative në funksion të përpunimit dhe publikimit të listës së subjekteve në kushtet e ndalimit të ushtrimit të detyrës, pas verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme.

Lista e cituar më sipër, përmban të dhëna personale të subjekteve deklaruese dhe publikimi i saj është një ndër detyrimet e ligjit nr. 138/2015. Këto të dhëna personale përpunohen dhe bëhen publike në përmbushje të një parashikimi ligjor, çka përbën një ndër kriteret e përpunimit i përcaktuar në germën “ç”, pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në kushtet kur, në referim të legjislacionit të posaçëm, ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, ka përfunduar periudha (afati) e ndalimit të kandidimit, zgjedhjes apo ushtrimit të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar, për funksionarët publik, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i këtyre të dhënave personale (publikimi) duhet të mbështetet në parimet e përpunimit të të dhënave personale

bazuar në gjuhën “d”, pika 1, e nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Konkretisht, vijueshmëria dhe metodologjia e përpunimit (publikimit) të këtyre të dhënave nga Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e kontrolluesit, duhet të respektojë parimin e afatit të përpunimit të të dhënave, që nënkupton mbajtjen e tyre në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, jo më të gjatë sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Rrjedhimisht, kur ka përfunduar afati i përpunimit të të dhënave ose qëllimi i përpunimit (në rastet kur nuk ka një afat specifik) të dhënat personale duhet të fshihen, ose shkatërrohen në varësi të formës së përpunimit të tyre. Kjo procedurë duhet të përcaktohet në “Rregulloren e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale” që çdo kontrollues publik ose privat ka detyrimin të miratojë në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Në çdo rast duhet të keni parasysh që fshirja ose shkatërrimi i të dhënave duhet të provohet dhe dokumentohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

